



10/Nr. 3542/2023
Data: 25.04.2023

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 19.04.2023 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 14:00 prezent ishin 21 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë z. Arsim Dernjani.

Rendi i Punës

1. Plotësim ndryshimi i rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.

Arsim Dernjani rregullorja është shqyrtuar në Komitet për Politikë e Financa dhe në Kuvendin e Komunës dhe proceduralisht duhet të diskutohet edhe në debat publik në mënyrë që qytetarët t'i japin propozimet. Duke marr për bazë ngritjen e çmimeve që janë bërë në deponi, ngritjen e çmimeve të derivateve, rregullimin e defekteve që shkaktohen gjatë punës kompania ka kërkuar që edhe çmimi të ngritet në 30 % e që për ekonomi familjare të jetë 6.50 €. E kuptojë që ndoshta është ngarkesë për qytetarët por me funksionuar kompania duhet të bëhet edhe ngritja e çmimeve. Kompania deri më tani është duke i kryer punët mirë. Ju mund të jepni propozime dhe propozimet e juaja do të përcillen për në Kuvend të Komunës dhe pastaj Kuvendi vendosë.

Ali Axhami propozoj që çmimi për ekonomi familjare të jetë 7 €.

Durim Dernjani për ata të cilët janë të punësuar nuk është problem nëse bëhet ngritja e çmimit por problem është për ata të cilët janë raste sociale dhe është mirë për me i liruar nga pagesa.

Arsim Dernjani përveç kategorisë sociale janë edhe kategoritë e dalura nga lufta por nuk e parasheh Ligji që komuna me i liruar nga pagesa kjo duhet ta bëhet prej nivelit qendrorë. A keni edhe ndonjë edhe ndonjë propozim konkret sa i përket çmimit, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 14:43.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Arsim Dernjani